



Republika e Kosovës
Komuna Drenas/Gllogoc
Kuvendi i Komunës



02- Nr 020/04-14942 dt. 28.03. 2023

Bazuar në nenin 11,12 dhe 40,të Ligjit Nr.03/L-040,për Vetëqeverisje Lokale, nenit 34,pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 6, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor, si dhe rekomandimit të DKA-së në Drenas, Kuvendi i Komunës së Drenasit/Gllogocit në mbledhjen e rregullt e mbajtur me datë,28.03.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

Për caktimin e anëtarëve të komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit

Neni 1

Më këtë Vendim caktohen anëtarët e komisionit përzgjedhës për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore të Komunës së Drenasit, si vijon:

1. Drilon Krasniqi – Fakulteti i Edukimit – Gjuhë Angleze (240 ECTS) + Fakulteti i Edukimit – Mësimdhënie dhe Korrikula (90 ECTS) dhe student i doktoratës për mësimdhënie në Slloveni.
2. Arben Haziri – Ma.sc. Gjuhë Shqipe (Këshilli i Prindërve);
3. _____ - Anëtar nga MASHTI.

Neni 2

Ky komision ka për detyrë që procedurat e përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve t'i zhvilloj në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MASH) Nr.151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të komisionit nga DKA për Drejtor dhe Zëvendës drejtor në Institucione Arsimore është për 1 vit.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Plani i dërgohet:
Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatese;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari